



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 29 tetor 2020, në mbledhjen e XXX-të (tridhjetë) mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhes, dhe filloi në orën 10;10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, Endritë Murati, Patriot Rudari, Vendenis Lahu, ndërsa mungoi, Arlinda Kadriu.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Durim Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit-DI, Gëzim Namani, Drejtor i Drejtorisë së Administratës-DA, Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DSHPMSH dhe Vezir Januzi, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, ndër të tjera theksoi, konsideroj se thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë të gjithë me kohë, kështu që mund fillojmë me punë në këtë takim, urdhëroni nëse dikush dëshiron fjalën.

z.Vendenis Lahu, theksoi, kërkoj që pika e dytë (2-të) e rendit të propozuar të ditës të shtyhet për një mbledhje tjetër të radhës sepse konsideroj se është një pikë shumë e rëndësishme dhe shumë delikate që është Harta Zonale e qytetit të Podujevës, po ashtu ka edhe pakënaqësi në mesin e qytetarëve si dhe përveç kësaj nuk e kemi edhe drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit të cilit do të mund t'i adresoheshin të gjitha shqetësime, kërkesat dhe ankesat e qytetarëve e që do të mund të jepte sqarimet dhe shpjegimet e nevojshme. Si pikë është shumë e rëndësishme dhe është shumë mirë që është sjellë dhe që është bërë ky dokument për të dalë në shqyrtim dhe votim por është mirë që kjo të shtyhet për muajin e ardhshëm.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së kërkoj që për seancën e nesërme të shtohet një pikë e rendit të ditës lidhur me kërkesën nga Komuniteti Ashkalinj drejtuar LVV-së, kërkesë e cila ka të bëjë me zbatimin e marrëveshjes së datës 04.03.2020 mes përfaqësuesit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës z.Agim Blakçori dhe OJQ-së “zëri i Romëve Ashkalinjve dhe Egjiptianve” z.Isak Skenderi drejtor ekzekutiv në VORAE, lidhur me qendrat mësimore në të cilat do të vijnë mësimin nxënësit e këtij komuniteti që janë qendra mësimore në shkollën fillore “DR.Ibrahim Rugova” dhe në shkollën fillore “Shaban Shala”, andaj meqë janë bërë 8 muaj nga arritja e Marrëveshjes në fjalë, zbatimi

i saj ka mbetur vetëm në letër e që si duket kjo letër është nënshkruar vetëm që të bëhet temë mediatike meqenëse ishte fushatë, se jo që është bërë për hallet e komuniteteve. Ne si Grup i LVV-së kërkojmë që të hyjë si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës dhe të filloj të zbatohet Marrëveshja e cekur.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, kemi dy propozime sa i përket rendit të propozuar të ditës, andaj i hedh në votim sipas radhës, fillimisht kërkesa e anëtarit z.Vendenis Lahu që ka të bëjë me heqjen nga rendi i ditës pikën 2 dhe e njëjta të shtyhet për seancën e radhës, si dhe propozimi i znj.Adelinë Stublla për futjen në rend të ditës kërkesën për zbatimin e marrëveshjes së nënshkruar nga DKA dhe VORAE.

4 vota ishin për, 4 vota kundër, asnjë të përmbajtur, mirëpo duke shfrytëzuar të drejtën e votës së dyfishtë të Kryesuesit të Kuvendi e cila ishte kundër, konstatohet se propozimi për heqjen e pikës së dytë (20-të) nga rendi i ditës nuk merr votat e mjaftueshme.

Gjithashtu, 4 vota ishin për, 4 vota kundër, asnjë të përmbajtur, mirëpo duke shfrytëzuar të drejtën e votës së dyfishtë të Kryesuesit të Kuvendi e cila ishte kundër, konstatohet se propozimi për të hyrë si pikë e veçantë në rend të ditës për seancën e nesërme si kërkesë për zbatimin e Marrëveshjes së nënshkruar nga DKA dhe VORAE, nuk merre votat e nevojshme.

Kryesuesi i Kuvendit, e hedh në votim rendin e propozuar të ditës në tërësi.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtura më 08 shtator 2020 dhe 29 shtator 2020

Njëzëri u miratuan procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtura më 08 shtator 2020 dhe 29 shtator 2020

2. Propozim vendimi për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për përdhën kohore 2020 – 2028

z.Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit – DI, theksoi, dëshiroj që vetëm të bëjë një njoftim lidhur me këtë propozim vendim për të cilin nga Zyra ligjore është vërejtur se është përvjedhë një gabim teknik i cili kërkohet të korrigjohet, në fakt fjala është që në propozim vendimin përkatës duhet të futet e dhe një nen i cili rregullon dispozitat shfuqizuese dhe atë, *me hyrjen në fuqi të këtij vendimit, përkatësisht miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës 2020-2028, shfuqizohen të gjitha planet hapësinore të Komunës së Podujevës, me përjashtim të Planit Zhvillimor Komunal 2016-2025*

z.Rafet Llapashtica, theksoi, meqë kjo pikë është një prej pikave më të rëndësishme e cila diskutohet në këtë seancë mirëpo propozim vendimi për shfuqizimin e planeve tjera nuk është sjellë si propozim për votim edhe pse me votën e dyfishtë të Kryesuesit të Komitetit ai propozim kaloj, mirëpo ka ankesa të qytetarëve, madje edhe tani para objektit të Komunës ka qytetarë të cilët kanë ankesa rreth pjesëve të caktuara në hartën Zonale se si është paraparë në disa pjesë, andaj do të ishte mirë që ndokush nga Ekzekutivi i Komunës të dal dhe të jap shpjegime rreth këtij dokumenti se çfarë është menduar në ato pjesë për të cilat qytetarët kanë ankesa e që sigurisht edhe juve ashtu sikurse mua më ndalën këtu në

hyrje duke më paraqitur ankesa dhe duke më njoftuar se kanë dërguar ankesë në formë të petitionit në drejtorinë përkatëse dhe në Kuvendin e Komunës, prandaj është mirë që ndokush të na informoj më në detaje edhe pse ish drejtori z.Hamdi Jaha nuk është. E them këtë sepse sa kuptova unë në aspektin procedural fillimisht duhet të sjellët propozimi për shfuqizimin e planeve paraprake e pastaj të shqyrtohet dhe vendoset për këtë propozim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës.

Me kërkesë të Kryesuesit zyrtari i Zyrës ligjore jep sqarim rreth kësaj çështje, konkretisht propozimit për plotësimin e propozim vendimit në fjalë, theksoi,

Ndoshta paksa u keqkuptua sepse nuk kemi të bëjmë me propozim vendim të ri rreth kësaj pike, mirëpo vetëm plotësim ndryshim të propozim vendimit i cili ju është dërguar, përkatësisht futjen e një neni të ri (neni 10) e që është lëshim teknik i cili është vërejtur pasi ju është dërguar materiali ngase nuk janë përfshirë dispozitat shfuqizuese në mënyrë që në rast të miratimit të këtij propozim vendimi për miratimin e Hartës Zonale, të shfuqizohen planet tjera përkatës sepse juridikisht për një çështje të caktuar nuk mund të jenë dy a më shumë dokumente në fuqi, përveç atyre që parashihen në Ligjin përkatës siç është Plani Zhvillimor i Komunës. Pra kërkohet që vetëm të futet edhe një nen shtesë (neni 10) ashtu siç e lexoj drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit në fjalën hyrëse.

z.Durim Salihu, drejtor i DI, theksoi, mua sot më është kërkuar që të bëjë një prezantim të këtij dokumenti. Sa jam në dijeni para se të thirret kjo seancë është kthyer përgjigja respektivisht vendimi për dhënien e pëlqimit nga ana e Ministrisë përkatëse lidhur me këtë dokument, pëlqim me të cilin natyrisht se si draft është në rregull dhe i njëjti mund të del për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës, dokument i cili është një obligim ligjor për të cilin Komuna e Podujevës para rreth 3 viteve ka filluar ta hartoj duke respektuar procedurat ligjore siç janë fillimi i hartimit, diskutimet publike, shqyrtimet publike, Vlerësimi Strategjik Mjedisor etj, të ngjashme për çka edhe Ministria përkatëse ka dhënë pëlqimin për miratim dhe tani jemi në këtë situatë që jemi.

Sa i përket ankesave, edhe tek unë në zyrë ishin një grup i qytetarëve të një pjese të qytetit të cilëve ju dhashë sqarime aq sa pata mundësi dhe njohuri mirëpo nuk jam unë ai që vendosi por jeni ju si Kuvendin ata që merrni vendim për dokumente të tilla, por sa për ankesat e qytetarëve për një pjesë të qytetit nuk e di sa mundemi ne të bëjmë ndryshim-plotësime në këtë dokument kur tani veç është dhënë pëlqimi nga Ministria, apo edhe mund t'i drejtohen instancave më të larta lidhur me këtë çështje.

z.Vendenis Lahu, theksoi, mënyra qysh është dërguar ky propozim vendim, pa përfshirë nenin për shfuqizim për të cilin u diskutua, unë e kam kuptuar se edhe nëse miratohen Harta Zonale nuk shfuqizohen dokumentet tjera dhe ka ndonjë problem rreth kësaj, mirëpo tani po thuhet që duhet të shfuqizohen planet tjera paraprake për shkak që të mos ketë dualizëm dhe kontradikta në mes planeve në fjalë dhe Hartës Zonale, andaj unë nuk e di si procedurë se si mund të futet ai nen shtesë në kuadër të propozim vendimit përkatës kur tani veçse kaloj si pikë e rendit të ditës pa atë nen shtesë i cili i shfuqizon planet tjera. Pra mendoj se procedurat ligjore kanë kaluar dhe tani është vonë për ta futë atë nen shtesë por duhet të sjellët për votim si dokument i plotë sepse nuk është pjesë e dokumentit që u votua për nesër kështu që nuk e di si procedurë si mund të futet një nen i ri kur nuk është pjesë e propozim vendimit.

z.Durim Salihu, drejtor i DI, po mundohem të kontribuoj me qëllimin që ta keni të qartë këtë çështje.

Sa i përket dokumentacionit të planifikimit hapësinorë e që është obligim ligjor për çdo Komunë që t'i ketë sipas Ligjit për Planifikimin Hapësinor, janë Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale dhe Planet Rregulluese të Hollësishme. Ne Planin Zhvillimor Komunal e kemi të miratuar dhe në fuqi dhe tani na duhet ta miratojmë edhe Hartën Zonale e që me automatizëm të gjitha planet tjera rregullative hapësinore shfuqizohen apo thënë ndryshe nuk vlejné më, pra është e rregulluar me ligj kjo, jo që e

themi ne, andaj edhe është vërejtur si standard ligjor që të futet edhe në propozim vendim shfuqizimi i tyre, çështje e cila siç u cek është përvjedhë teknikisht apo vetëm është harruar të potencohet gjatë hartimit të këtij propozim vendimi, nuk është diçka tjetër, unë kështu e kuptova.

z.Mehmet Gashi, theksoi, nesër është mbledhja e Kuvendit dhe propozoj që përfaqësuesi i Ekzekutivit të Komunës të del dhe ta arsyeton këtë draft të Hartës Zonale por gjithashtu është mirë të sjellët edhe raporti nga diskutimi/shqyrtimi publik për këtë dokument në mënyrë që të njoftohemi se ka pasë apo jo ndonjë ndryshim. Sa i përket kërkesës së një grupi të qytetarëve që u përmend se ka ardh tani së fundmi duhet ta diskutojmë dhe të shohim se a mund të bëhet ndonjë ndryshim, kështu që nuk po e shohë të arsyeshme që ne sot të diskutojmë edhe më gjerë ngase nesër e kemi për shqyrtim dhe miratim në seancën e Kuvendit.

Në të kaluarën kanë qenë tri plani urbanistike, Plani Zhvillimor Komunal si plan i përgjithshëm hapësinorë i Komunës, Plani Zhvillimor Urban si dhe Planet Rregulluese. Pra Planin Zhvillimor Komunal e kemi të miratuar dhe është në fuqi ndërsa me Hartën Zonale zëvendësohen Planin Rregullues Urban dhe Planet Rregulluese të cilave edhe ashtu ju është skaduar afati por që me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Hartës Zonale edhe ashtu me automatizëm këto dy plane shfuqizohen dhe kjo është e kuptueshme andaj neni i cili u propozua të përfshihet në kuadër të propozim vendimit është i natyrshëm dhe duhet të jetë ashtu, mirëpo për nesër duhet të jemi të përgatitur dhe të arsyetohet ky dokument nga përfaqësuesi i ekzekutivit si dhe të njoftohemi me raportin e diskutimit/shqyrtimit publik.

Me këto që i ceka, e mbështesë që t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, konsideroj se u sqaruam rreth kësaj pike, andaj nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo e vë në votim që kjo pikë t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim duke përfshirë edhe propozimin për përfshirjen e një neni në kuadër të propozim vendimit përkatës ashtu siç u cek nga drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit, si dhe çështje tjera të arsyeshme që u cekën nga anëtarët e Komitetit.

Me 4 vota për, 4 vota kundër, asnjë të përmbajtur, mirëpo duke shfrytëzuar të drejtën e votimit të dyfishtë të Kryesuesit, që ishte për, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës, duke përfshirë edhe propozimin për:

Plotësimin e propozim vendimit, dhe atë;

Neni 10

- *Me hyrjen në fuqi të këtij vendimit, përkatësisht miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës 2020-2028, shfuqizohen të gjitha planet hapësinore të Komunës së Podujevës, me përjashtim të Planit Zhvillimor Komunal 2016-2025, (si lëshim teknik, sepse kjo është paraparë edhe në vetë dokumentin e Hartës Zonale), kurse neni 10 aktual kalon në nenin 11), si dhe,*
- *Dërgimin e raportit të shqyrtimi publik dhe procesit të pjesëmarrjes në hartimin e Hartimit të Hartës Zonale të komunës së Podujevës 2020-2028, në Kuvendin e Komunës për seancën e caktuar më 30.10.2020 (që është pjesë e Konstatimeve)*

3. Propozim vendimi për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës

Meqë nuk pati të interesuar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës.

4. Kërkesë për nismën e procedurës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit me Qytetin AMES të Shtetit të IOWA në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

- **Propozim vendimi për miratimin e nismës së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – binjakëzim me Qytetin Ames të Shtetit të Iowa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës**
- **Propozim vendimi për autorizimin e fillimit të konsultimeve për binjakëzim me Qytetin Ames të Shtetit të Iowa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës**

Po ashtu meqë nuk pati të interesuar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës

5. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën nëntëmujore janar – shtator 2020

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës drejtori i drejtorisë së Buxhetit dhe Financave më ka paralajmëruar se nuk mund të jetë prezent sot në këtë mbledhje të Komitetit, kështu që nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni.

z.Mehmet Gashi, theksoi, si rregull është që paraprakisht drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave ta paraqesë një fjalë hyrëse rreth dokumenteve të tilla, mirëpo shpresoj që nesër në seancën e Kuvendit do të jetë prezent dhe do të jap sqarimet dhe arsyetimet përkatëse rreth këtij raporti andaj meqë sot nuk është prezent nuk dëshiroj të lëshohem në detaje të këtij raporti, përveç disa gabimeve teknike që kam vërejtur në raport e që është mirë të përmirësohen, konkretisht në 2-3 raste thuhet “*raporti financiar gjashtëmujor janar – qershor 2020*” andaj do të ishte mirë të bëheshin përmirësime sepse kemi të bëjmë me raportin financiar nëntëmujor janar – shtator 2020, përndryshe si Grupi i këshilltarëve të LDK-së e mbështesim dhe e rekomandojmë për diskutim në mbledhjen e Kuvendit me kërkesën që prezent të jetë edhe drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në mënyrë që të përgjigjet këshilltarëve dhe të jap sqarime rreth këtij raporti.

Meqë nuk pati diskutime tjera, Kryesuesi i Komitetit e konstatoi se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim, me korrigjimet teknike që në disa faqe ku thuhet “raporti gjashtëmujor”, të korrigjohet/zëvendësohet me Raporti Nëntëmujor.

6. Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit, për Komunën e Podujevës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2019

- Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, gjithashtu edhe për këtë pikë të rendit të ditës nuk është prezent drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave që ta paraqesë fjalën hyrëse.

z.Mehmet Gashi, ndër të tjera kërkoj që edhe për këtë pikë të rendit të ditës është mirë që nesër në seancë të jetë prezent drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në mënyrë që të jap sqarimet dhe përgjigjet e nevojshme sa i përket raportit në fjalë.

z.Rafet Llapashtica, ndër të tjera theksoi, mendoj që është e pakuptimtë që kjo pikë por edhe ajo paraprake të rekomandohen për Kuvend sepse për të dy këto pika nuk është prezent drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave i cili do të duhej të jepte arsytetime dhe shpjegime përkatëse.

Kjo për shkak se disa prej drejtorëve të Drejtorive edhe mund ta marrin fjalën dhe ta arsyetojnë punën e vetë, e them këtë për shkak se ne si opozitë mund të kemi kritika dhe të kërkojmë sqarime dhe përgjigje por edhe mund të mos jemi të informuar për çështje të caktuara, mirëpo kur të argumentohen ato nuk do të thotë që të gjithë mund të jemi kundër, prandaj do të ishte mirë që nesër patjetër të jetë prezent drejtori përkatës apo ndokush nga Ekzekutivi i Komunës që të jap sqarime, arsytetime dhe përgjigje në mënyrë që të kjo të mos reflektoj edhe e tëra si politike për faktin që jemi edhe në proces zgjedhor.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, shpresoj se nesër drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave do të jetë prezent në mbledhje, edhe pse nuk mund të garantoj, andaj pa dashur ta zgjatim këtë e vë në votim këtë pikë që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

7. Informatë e Drejtorisë së Administratës lidhur me punët dhe aktivitetet gjatë vitit 2020.

z.Gëzim Namani, drejtor i Drejtorisë së Administratës – DA, ndër të tjera theksoi, ashtu siç është paraparë me planin e punës së Kuvendit, edhe pse kjo seancë ishte paksa e ngarkuar, ne e kemi sjellë një informatë të përgjithshme për punët dhe aktivitetet gjatë vitit 2020.

Jeni në dijeni se si DA jemi të hapur gjithëherë sa i përket kontakteve, pyetjeve dhe përgjigjeve për çështje që ndërlidhen me këtë Drejtori. Sa i përket aspektit financiar n'kuadër të Drejtorisë së Administratës nuk kemi paraqitur shifra dhe projekte ngase janë të përfshira në Raportin Financiar për periudhën janar – shtator 2020, andaj në qoftë se ndokush ka diçka mundet lirshëm të më drejtohet përmes e-maili, apo forma tjera e që ne jemi të hapur për çka do qoftë.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën Kryesuesi i Komitetit konstatoj se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

8. Emërimi i anëtarëve të rinj të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim SH.A. Podujevë (pasi që 2 ish anëtarët nuk janë më këshilltarë të Kuvendit)

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sigurisht jeni në dijeni që dy ish anëtarët e këtij Komisioni tani më nuk janë anëtarë të Kuvendit të Komunës, prandaj na duhet që t'i emërojmë dy emra tjerë nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Nëse sot nuk janë të përgatitur Grupet e këshilltarëve që t'i propozojnë emrat, ne mund të rekomandojmë që të njëjtit të propozohen në seancën e Kuvendit.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim, me sugjerimin që gjatë shqyrtimit të kësaj pike në Kuvend, të propozohen emrat për anëtarë/e të Komisionit në fjalë.

Kryesuesi i Komitetit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:35

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/01-0065538/20
Podujevë,
29 tetor 2020**

**Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Gashi**